



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM LËNDOR PËR ARSIMIN BAZË
NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR TË MITUR**

Lënda: Art pamor

Klasat: VI, VII, VIII, IX

Tiranë, 2018



	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data	Nënshkrimi
Koordinoi:	M.Hala	Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve	___.11.2018	
Pranoi:	D.Rapti	Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	___.11.2018	

Përmbajtja e Programi

I. Hyrje	5
II. Korniza konceptuale e programit.....	5
1. Qëllimet e programit të artit pamor	9
2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës	10
3. Lidhja e artit pamor me temat ndërkurrikulare	12
4. Lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare	12
5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj	17
6. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë.....	19
III. Përmbajtja e shkallës së tretë dhe të katërt	22
1. SHKALLA E TRETË.....	Error! Bookmark not defined.
1.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik	Error! Bookmark not defined.
1.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike	Error! Bookmark not defined.
1.3 Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.....	Error! Bookmark not defined.
2. SHKALLA E KATËRT	Error! Bookmark not defined.
2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik	Error! Bookmark not defined.
2.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike	Error! Bookmark not defined.
2.3 Tematika: Historia, kultura dhe shoqëria.....	Error! Bookmark not defined.
IV. Udhëzime metodologjike	41
V. Udhëzime për vlerësimin	43
VI. Materiale dhe burime mësimore.....	44

Tabelat dhe digramat

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	9
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor për shkallën e tretë dhe të katërt.	12
Digrama 3: Lidhja ndërmjet artit pamor dhe fushave të tjera.	16
Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës.	Error! Bookmark not defined.
Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës	19
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	21

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Mësimi i arteve u ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar njohuritë artistike përmes mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, formave, fjalës, lëvizjeve. Ato mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave e proceseve artistike, nxisin të mësuarit konkret të artit gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme. Kompetencat përmbajtësore, që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët, kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë, kërcim dhe dramë* si lëndë të detyrueshme në *shkallën e parë, shkallën e dytë, shkallën e tretë* dhe në *shkallën e katërt*.

Fusha e arteve në *shkallën e tretë, art pamor, muzikë dhe dramë*, fokusohet në aftësimin e nxënësve në vëzhgimin, reflektimin, komunikimin dhe përdorimin e informacionit nga burime të ndryshme. Ndërsa në *shkallën e katërt* ata fillojnë të krijojnë dhe performojnë/realizojnë në mënyrë më sistematike, vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta nëpërmjet njohjes dhe gjykimit të zhvillimit të tyre historik, duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike. Artet janë konceptuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Aspektet e të nxënit në fushën e arteve, do të zhvillojnë mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar dhe për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve, mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare.

I. Hyrje

“Arti pamor”¹ është një mënyrë për të krijuar dhe komunikuar nëpërmjet imazhit. Lënda e artit pamor është një lëndë e veçantë dhe ka kërkesat e veta specifike të të mësuarit. Veprimtaritë e artit pamor bëjnë të mundur që nxënësit të bëjnë lidhjen midis botës reale dhe imagjinare, të organizojnë dhe të shprehin vizualisht idetë, ndjenjat dhe eksperiencat nëpërmjet teknikave të larmishme artistike. Edukimi nëpërmjet “Artit pamor” siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit, trillimit, vizatimit dhe përdorimit të një sërë mjeteve dhe teknikave. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe ndihmon nxënësit të fitojnë ndjeshmëri për botën vizuale, hapësinore dhe të prekshme dhe për eksperiencat estetike.

Arti pamor ka të bëjë me materializimin e mendimit i cili shpreh një realitet social kulturor. Që në fillimet e njerëzimit, njerëzit e kanë përdorur artin si një mënyrë për të përcjellë botëkuptimin e tyre nëpërmjet imazhit, duke përdorur aftësi që kanë qenë të ndryshme në varësi të vendit, periudhës historike dhe kulturës. Prezenca e imazheve përgjatë shekujve tregon për rëndësinë e madhe që kanë njohuritë artistike për njeriun dhe që ato kanë zënë rrënjë në ndjeshmërinë, intuitën dhe imagjinatën e tij. Artistët gjithashtu kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e ideve dhe si rrjedhojë edhe të shoqërisë duke shprehur bindjet, vlerat dhe shqetësimet përmes veprave të tyre të artit.

Në artin pamor imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve dhe materialeve që përdoren për ta realizuar atë. Imazhi mund të jetë dy ose tre dimensional, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik etj. Gjithashtu, ai krijohet duke përdorur teknika të ndryshme artistike. Përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës vizuale në një vepër varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë.

Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit dhe pasuron kulturën e tij/saj. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik dhe ndjenjën estetike. Sot në kulturën edukative i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social, ekonomik dhe artistik të nxënësve.

¹ Hyrja dhe pjesët e sqaruese të programit, janë njësoj si për shkallën e tretë ashtu edhe për shkallën e katërt.

Shkalla e tretë dhe e katërt e këtij programi janë vazhdimësia e shkallës së parë dhe të dytë dhe bazohen në të. Ky program bën të mundur konsolidimin e mëtejshëm të njohurive të artit pamor. Nxënësit vijnë nga cikli fillor me eksperiencat pamore që i korespondojnë nivelit të tyre njohës, emocional, social dhe zhvillimit psikomotor.

Ashtu si programi i artit të ciklit fillor edhe në këtë cikël ky program bazohet në tre kompetenca, krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit.

Ky program ka për qëllim që nëpërmjet artit pamor të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë krijuese, komunikuese, të kuptojnë botën që i rrethon.

Krijimtaria në art, kontribuon në formimin e një identiteti personal e të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike. Nxënësit kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar. Në këtë nivel ata mësojnë të ushtrojnë mendimin kritik dhe të zhvillojnë ndjesitë e tyre estetike nëpërmjet vlerësimit jo vetëm të punëve të tyre dhe të shokëve/shoqeve, por edhe të veprave të artit, të objekteve tradicionale dhe imazheve të mediave të marra nga historia dhe trashëgimia kulturore e të tashmes dhe e të shkuarës. Nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxënësit inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere. Në këtë mënyrë nxënësit hapin një dritare me botën për të zbuluar karakteristikat e veçanta të saj dhe të kuptojnë më mirë kulturën e tyre, zhvillojnë identitetin e tyre kulturor dhe përgatiten për rolin e tyre si qytetar.

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së artit pamor, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri;
- **mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe artritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- **prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara;
- **hartuesve** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi përmban edhe **tri tematikat** të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqiten edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Kompetencat kyçe të të nxënësve në lëndën e artit pamor janë:

- Krijimi artistik
- Realizimi i punimit
- Vlerësimi i veprave të artit


Vendi që zë zhvillimi i çdo kompetence në program varet në mënyrë të veçantë nga natyra e tematikës. Kompetenca e parë dhe e dytë kanë përparësi për njohuritë që duhen fituar. Ato nënkuptojnë një proces në të cilin merren njohuri specifike të artit pamor mbi gjuhën artistike, rregullat, parimet dhe mjetet specifike, ku gjithashtu zhvillohen aftësitë komplekse psikomotorë brenda një kohe të mjaftueshme për t'u asimiluar. Kompetenca e tretë është thelbësore për zhvillimin e mendimit kritik dhe ndjenjës estetike të nxënësve. Kjo kompetencë ndjek dy kompetencat e para duke vendosur në qendër proceset e komunikimit dhe vlerësimit. Vendi që zë kjo kompetencë rritet më shumë në këtë cikël, ashtu siç njohuritë që lidhen me dy kompetencat e tjera konsolidohen në bashkëpunim me zhvillimin intelektual dhe shpirtëror të nxënësve.

Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së artit pamor është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e artit pamor dhe të gjitha arteve të tjera që përbëjnë fushën e arteve, në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e artit pamor me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Përdorimi i *metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor* është kusht parësor për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program *vlerësimi i nxënësve*, është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i artit, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit



1. Qëllimet e programit të artit pamor

Programi i artit pamor, nëpërmjet përmbajtjes së përcaktuar sipas tematikave, ka si qëllim ndërtimin dhe zbatimin e njohurive bazë të nxënësve për formimin artistik, zbulimin e cilësive vizuale të objekteve dhe imazheve nga mjedisi, zhvillimin e aftësive pamore, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve. Ky program synon aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të artit shqiptar dhe atij botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, përfshirjen në veprimtari artistike, duke manifestuar vlerësim ndaj artit pamor kombëtar si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit, ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave të artit pamor për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme artistike.

Në këtë lëndë nxënësi kupton dhe argumenton qëndrimet e veta, duke ua paraqitur të tjerëve, edukohet të punojë në grup, ndihet i suksesshëm në artin pamor.

2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.*** Organizimi i mësimin të artit pamor me bazë kompetencat përqëndrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësi realizon kompetencat e lëndës së artit pamor, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. Psh. Kompetenca e artit pamor “Krijimi artistik” përfshin njohuritë mbi gjuhën vizuale të cilat i zbulon në objektet, mjedisin që i rrethon veprat e artit dhe i përdor ato në krijimet e veta për të shprehur ndjenja e mendime të realizuara përmes teknikave artistike duke zgjidhur problemet në detyrën e tij/saj në mënyrë të pavarur.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës së artit pamor, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Në zhvillimin e kompetencave të artit pamor, nxënësi gjithashtu, zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me krijimtarinë, realizimin, vlerësimin e artit pamor, përpunimin e informacionit për veprat e artit, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efektiv etj. Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së artit pamor që synon të arrijë nxënësi;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e artit pamor.

Digrama 2: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor për shkallën e tretë dhe të katërt

SHKALLA E TRETË	SHKALLA E KATËRT
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • krijon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike; • kupton drejt mesazhet, që u adresohet; • shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale; • është komunikues efektiv; • orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike; • gjykon drejt mesazhet, që u adresohet; • sqartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale; • komunikon qartë mendimin e tij/saj; • shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.
Kompetenca e të menduarit	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • merr dhe përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; • zgjidh probleme të ndryshme artistike; • zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese; • ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari. 	<p>Nxënësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; • zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike; • zhvillon aftësitë për të menduar dhe argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese; • ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari artistike.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	
<p>Nxënësi:</p>	<p>Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik; • përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim; • zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. 	<ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik; • përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim; • zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete në artin pamor brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese; • kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese; • kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
Kompetenca personale	
<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; • përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet; • rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • krijon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; • merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet; • ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.
Kompetenca qytetare	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; • respekton punën e vet dhe të të tjerëve; 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; • respekton punën e vet dhe të të tjerëve;

<ul style="list-style-type: none"> • bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët. 	<ul style="list-style-type: none"> • bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.
Kompetenca digjitale	
<p>Nxënësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetete informuese në internet; • njih dhe përdor mjetet audio, video Cd, Dvd, aparat fotografik dixhital, kamera, etj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetete informuese në internet; • përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik si: video Cd, Dvd, aparat fotografok dixhital, kamera, etj.

3. Lidhja e lëndës së artit pamor me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Arti pamor ka një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe është i lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ai jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Mjedisi; Bashkëjetesa paqësore* nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve artistike, duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme duke dhënë kontributin e vet, duke dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme pamore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë artistike për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme që lidhen dhe me fusha të tjera që ata mësojnë. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave të artit pamor me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi përdor aftësitë e tij pamore që kanë të bëjnë me simbole, vizatime grafike për të zhvilluar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet dhe dukuritë pamore në botën e tij dhe ndërvarësitë e mjedist dhe botës njerëzore (format dhe ngjyrat).


Nxënësi mëson të komunikojë dhe shprehet përmes gjuhës pamore në krijimet e tij nëpërmjet përdorimit të ideve origjinale, gjuhës artistike teknikave të larmishme, duke eksperimentuar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike.

Nxënësi fillon të familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të artit, duke shpjeguar kuptimin e tyre dhe duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

4. Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika, etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si kërcimin, muzikën, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Nxënësit nxiten të bëhen të vetëdijshëm për një numër procesesh që lidhen me karakteristikat kryesore të kompetencave kroskurrikulare të cilat krijojnë lidhje me njohuritë në lëndët e tjera. Kompetencat e artit pamor mundësojnë nxënësit të përdorin informacionin, të zgjidhin problemin, të ushtrojnë mendimin kritik, të zbulojnë metoda pune efektive, të përdorin informacionin dhe komunikimin teknologjik, të zhvillojnë identitetin e tyre personal, të punojnë me të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme. Kështu që edhe në këtë cikël, mësuesit përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes objektivave të njohurive:

Digrama 3: Lidhja ndërmjet artit pamor dhe fushave të tjera.



5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë *3 kompetencat e lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet *3 tematikave kryesore*.

Kompetencat e lëndës:

Kompetenca 1: Krijimi artistik

Kompetenca 2: Realizimi i punimit

Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave të artit

Tematikat e lëndës:

Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi artistik

Tematika 2: Teknika dhe procese artistike

Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria

Digrama 4: Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës.




Tabela 1: Përshkrimi i kompetencat e lëndës, nëpërmjet tematikave të lëndës

Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Realizimi nëpërmjet tematikave
Krijimi artistik	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor ide personale dhe stimuj për krijim; - zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike; - përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; - përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike; - përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike; - analizon qëllimin e tij/saj krijues; - identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbulon elementët e gjuhës vizuale në mënyrë personale dhe i përdor për të realizuar idetë e veta përmes imazheve; - përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike; - eksperimenton për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme; - përdori qëllimshëm elemente të gjuhës artistike, e cila është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues; përdor gjuhën pamore dhe komunikimin e ideve origjinale; zbulon ide të reja, përdor burime të ndryshme informacioni, ben skica dhe përcakton qëllimin krijues.
Realizimi i punimit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; - krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike. - zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, tradicionale dhe dixhitale, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - ndan eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit; - zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim; - eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj; - analizon qëllimin e tij/saj krijues; - identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur. 	<ul style="list-style-type: none"> - eksperimenton me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar; - zhvillon aftësitë e tij për të organizuar gjuhën vizuale nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët; - bëhet i ndërgjegjshëm dhe i pavarur në përdorimin e teknikave të ndryshme artistike dhe realizimin e ideve origjinale; - zbulon gjatë procesit krijues, mundësitë e shumta shprehëse procesit krijues që ofrojnë teknikat artistike dy dhe tre dimensionale; - përdor burime të ndryshme informacioni, eksperimenton dhe përcakton qëllimin krijues.
<p>Vlerësimi i veprave të artit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; - identifikon veprat e artit në aspektin e tyre historik; - identifikon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj; - Interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik; - përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe eksperiencën e tyre artistike; - identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon dhe interpreton vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social kulturor; - komunikon emocionet dhe gjykimin e tij mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij dhe të shokut; - vlerëson aspektet e cilësisë simbolike dhe shprehëse të veprave të artit duke marrë parasysh kontekstin historik të tyre; - përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar eksperiencën e tyre artistike dhe atë që kanë mësuar nga kjo eksperiencë; - pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e

	<p>përdorur;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri; - identifikon një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor. 	<p>njohur më mirë atë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme dhe identifikon një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor.
--	--	---

6. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë

Lënda e artit pamor zhvillohet për 30 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 30 orë për secilën klasë. Programi i lëndës së artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e gjashtë	5	20	5	30 orë
Klasa e shtatë	5	20	5	30 orë
Klasa e tetë	5	20	5	30 orë
Klasa e nëntë	5	20	5	30 orë
Shkalla e tretë	20	80	20	120 orë

III. Përmbajtja e shkallës së tretë dhe të katërt

Në programin e lëndës, për shkallën e tretë janë paraqitur tematikat përmbajtësore të artit pamor të cilat vazhdojnë të jenë tre: *Gjuha dhe komunikimi artistik; Teknika dhe procese artistike; Historia, arti dhe shoqëria*. Këto tematika përdoren për të realizuar rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor për shkallë të paraqitur në tabelë në fillim të çdo tematike.

Për secilën **tematikë** është përcaktuar grupi i njohurive për shkallën e tretë (*klasa e gjashtë dhe klasa e shtatë*) dhe për shkallën e katërt (*klasa e tetë dhe klasa e nëntë*).

Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle (*shkalla tretë dhe shkalla e katërt*).

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave në këtë renditje. Kombinimi, ndarja e njohurive dhe koncepteve pamore në situata të nxëni, grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (*mësuesit dhe autorët e teksteve*).

Për “përkthimin” e programit të shkallës në tekste mësimore apo programe lëndore për çdo vit mësimor, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në tematika dhe njësi mësimore të zhvilluara logjikisht.

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ndërsa janë të lirë të ndryshojnë me 10% (*shtesë ose pakësim*) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

3. SHKALLA E TRETË DHE E KATËRT

3.1. Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik

Përshkrimi i Tematikës

Në këtë tematikë nxënësi/sja:

zbulon elementët e gjuhës vizuale dhe i përdor për të realizuar idetë e veta përmes imazheve. Përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike. Proçesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin e nxënësit për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme. Personalizimi i temave dhe subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi artistik:** përdor ide personale dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike; përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike; analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- **Realizimi i punimit:** zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim; merr në konsideratë target grupin të cilit i referohet me idetë e tij/saj; eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- **Vlerësimi artistik:** identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; identifikon veprat e artit në aspektin e tyre historik; identifikon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj; interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik; identifikon elementë të eksperiencës së

tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
KLASA 6	
<p>Shenja dhe pika</p> <p>Vija:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilësitë e linjës. - Vija si mjet shprehës. <p>Forma dy dimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forma natyrale, format gjeometrike <p>Ngjyrat :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perceptimi i ngjyrës - Ngjyrat primare, ngjyrat sekondare - Ngjyrat e ngrohta, ngjyrat e ftohta <p>Tekstura :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstura të ndryshme. (natyrale dhe artificiale) <p>Vëllimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drita dhe hija (hija e objektit dhe hija e mbartur) <p>Hapësira:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e hapësirës, planet. <p>Barazpesha:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simetria dhe asimetria 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - eksperimenton me lloje të ndryshme shenjash, shenja grafike, shenja piktorike, shenja plastike duke kuptuar rëndësinë e saj komunikuese; - përdor cilësitë e ndryshme të vijës për qëllime të caktuara në krijimet e veta; - përdor mjete të ndryshme artistike si lapsi, stilolapsi, karboni, lapustila, rapitografi, etj, për të krijuar emocione të caktuara nëpërmjet vizatimeve me vijën. - identifikon që edhe format bazë gjeometrike gjenden edhe në natyrë; - zhvillon format gjeometrike në një dekoracion; - analizon format natyrale në veprat e artistëve Paul Klee dhe Vasilij Kandinsij. - kupton zberthimin e dritës së bardhë në ngjyra, nëpërmjet prizmit; - përdor bojëra me bazë ujin, transparente dhe opake, penelat e përshtatshëm për të krijuar me përzierjen e ngjyrave parësore, dytësore, të ngrohta dhe të ftohta. - identifikon shembuj të ndryshëm të teksturës në natyrë dhe i interpreton në krijim, mbi sipërfaqe dy dhe tre dimensionale. - paraqet në mënyrë realiste një objekt ose disa objekte në marrëdhënie midis tyre nëpërmjet dritë hijes mbi një sipërfaqe dy dimensionale; - zhvillon perceptimin vizual të distancave dhe thellësisë;

	<ul style="list-style-type: none"> - zbulon dhe paraqet në krijim raportet hapësinore midis objekteve: përpara/mbrapa, sipër poshtë, etj. - zbulon simetrinë në natyrë dhe në art dhe përdor aksin e simetrisë dhe simetrinë rrethore në krijimet e veta; - zbulon që asimetria është e kundërta e simetrisë dhe kupton rëndësinë e përdorimit të asimetrisë në veprat e artit dhe arkitekturë.
KLASA 7	
<p>Vija:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vija krijon siluetin, tregon drejtimin. <p>Forma dy dimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format dinamike (në lëvizje) <p>Ngjyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilësitë e ngjyrës. <p>Tekstura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstura të ndryshme (në pikturë dhe stampim) <p>Vëllimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Burimi i dritës <p>Hapësira:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Treguesit hapësinor <p>Harmonia :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Motivi dhe ritmi 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor vijën për të krijuar siluetin dhe formën tre dimensionale të objekteve, në krijim; - zbulon që vija tregon drejtim në natyrë dhe mjedisin që e rrethon, dhe përdor shenjën grafike në krijim; - zbulon format dinamike në imazhe fotografike dhe në vepra arti; - vizaton forma dinamike në krijim për një qëllim të caktuar (format e reve në lëvizje, dallgët e detit, etj); - dallon karakteristikat fizike të ngjyrës (emërtimin, tonalitetin dhe intensitetin); - përdor gradacionet tonale të ngjyrës për të krijuar hapësirën atmosferike në krijim; - zbulon që tekstura në pikturë është e lidhur ngushtë me mënyrën e punimit të artistit dhe me materialet e përdorura; - përzgjedh materialin dhe shenjën grafike për të krijuar teksturën në një krijim. - zbulon se mënyra se si e percepton syri ynë objektin, varet nga burimi

	<p>i dritës mbi objekt;</p> <ul style="list-style-type: none"> - fotografon objekte të vendosura në burime të ndryshme të dritës. - zbulon disa rregulla të thjeshta të paraqitjes me intuitë të hapësirës në veprat e artit; - përdor këto rregulla për të paraqitur hapësirën në krijim; - zbulon ritmin në natyrë në jetën e përditshme dhe në art; - përsërit motivin në kombinime të ndryshme ritmike në dekoracione ose stampime.
KLASA 8	
<p>Vija - Vija në pikturë dhe vizatim.</p> <p>Forma dy dimensionale - Format figurative dhe abstrakte.</p> <p>Ngjyrat - Kontrasti i ngjyrave.</p> <p>Tekstura - Tekstura në skulpturë dhe arkitekturë.</p> <p>Vëllimi - Drita dhe hija: hija dhe perspektiva.</p> <p>Hapësira (Paraqitja perspektive e hapësirës). - Perspektiva këndore ose me dy pika ikjeje.</p> <p>Theksi dhe qendra e interesit.</p> <p>Proporcionet - Portreti.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon cilësinë e vijës në pikturë, vizatim dhe skica në varësi të mjeteve specifike të përdorura; - përdor mjete të ndryshme artistike për të realizuar cilësinë e dëshiruar të vijës në krijim, vizatim, pikturë; - analizon format figurative dhe format abstrakte si mjete shprehëse në art; - përdor format abstrakte simbolike në krijim; - eksperimenton me bojëra me bazë ujë për të kuptuar llojet e kontrastit të ngjyrave; - përdor bojëra me bazë ujë dhe penelat e përshtatshëm për të krijuar kontrastin e ngjyrave në krijim; - identifikon shembuj të ndryshëm të teksturës në skulpturë dhe arkitekturë dhe i interpreton në krijim, mbi sipërfaqe dy dhe tre dimensionale; - identifikon që hija e objektit mbi një plan ndjek rregullat e perspektivës; - zbulon raportin midis hijes dhe burimit të dritës;

	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon paraqitjen perspektive të hapësirës në vepra arti dhe në natyrë; - përdor perspektivën lineare këndore me dy pika ikjeje për qëllime të caktuara në krijim; - analizon organizimin e elementëve për të krijuar qendrën e interesit në një vepër arti. - përdor elementët e artit për të krijuar qendrën e interesit në krijim për një qëllim të caktuar.
KLASA 9	
<p>Vija</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vija në skulpturë dhe arkitekturë. <p>Forma dydimensionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format pozitive dhe negative. <p>Ngjyrat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrat monokromatike. <p>Tekstura</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstura si mjet shprehës në dizajn. <p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe në vizatim. <p>Hapësira</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perspektiva me tri pika ikjeje. <p>Kompozimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekuilibri ose pesha pamore. - Figura e njeriut. 	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon cilësinë e vijës në vepra dhe punime tredimensionale, skulpturë, relief, arkitekturë etj; - përdor mjete të ndryshme artistike për të realizuar cilësinë e dëshiruar të linjës në krijim në punime tredimensionale, relief, konstrukcion etj.; - identifikon raportin midis formës pozitive dhe formës negative (figurë/sfond) në veprat e artit; - zbulon nëpërmjet eksperimentit të ndërthurjes së formave pozitive dhe negative, iluzionin optik; - zbulon rëndësinë e përdorimit të ngjyrave monokron për të arritur efektet e vëllimit dhe të hapësirës; - përdor bojëra me bazë uji për të krijuar ngjyrat monokron dhe i përdor ato në krijim; - zbulon teksturën si një mjet shprehës të rëndësishëm në dhe dizajn; - përdor teksturën në krijim për një qëllim të caktuar; - zbulon raportet midis lartësisë, gjerësisë dhe thellësisë të objekteve tredimensionale dhe mënyrat e paraqitjes së tyre në pikturë dhe vizatim;

	<ul style="list-style-type: none"> - përdor perspektivën me tre pika ikjeje (pika shikimi nga poshtë lartë, nga lartë poshtë) për një qëllim të caktuar në krijim; - zbulon që ekuilibri ose pesha pamore në kompozim arrihet nga bashkëpunimi i elementëve të artit; - përdor formën dhe ngjyrën për të arritur ekuilibrin në krijim; - identifikon proporcionet dhe lëvizjet e figurës së njeriut dhe i përdor në krijim.
--	---

3.2. Tematika: Teknika dhe procese artistike

Përshkrimi i Tematikës

Në këtë tematikë nxënësi/sja:

krijon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike. Ai zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit. Një vend të rëndësishëm ze përzgjedhja e qëllimshme e teknikave artistike nga nxënësi, eksperimentimi me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar. Gjithashtu ai zhvillon aftësitë e tij për të organizuar gjuhën vizuale nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi artistik:** përdor ide personale dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike; përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike; analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

- **Realizimi i punit:** zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim; merr në konsideratë target grupin të cilit i referohet me idetë e tij/saj; eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- **Vlerësimi artistik:** identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; identifikon veprat e artit në aspektin e tyre historik; identifikon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj; interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
--	---

KLASA 6

<p>Vizatimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat grafike: vizatimi me laps, karbon. <p>Piktura;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Akuaarel, mozaiku. <p>Stampimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monotipi, stampa me relief dhe gërryerje. <p>Fotografia:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Imazhe fotografike, aparati fotografik. <p>Grafk dizajni dhe prezantimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekt artistik. <p>Skulptura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Modelimi me plastelinë, baltë, karta pesta. - Gdhendja mbi materiale të buta. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - eksperimenton dhe krijon me mjete dhe teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në natyrë, në mjedis , në eksperiencia personale, te fantazia për të komunikuar ide; - krijojn duke përdorur karakteristikat shprehëse të mjeteve të vizatimit si: gradacionet tonale të lapsit dhe gomës, karbonit etj; - paraqet formën tre dimensionale mbi sipërfaqen dy dimensionale. - zbulon efektet e teknikës së akuarelit dhe i përdor në krijim; - zbulon karakteristikat e teknikës së mozaikut dhe i përdor në krijim; - përdor teknikën e monotipit për të stampuar mbi sipërfaqe me tekstura të ndryshme; - krijon stampa me relief dhe nëpërmjet gërrierjes dhe stampon mbi sipërfaqe me teksturë të ndryshme; - zbulon që imazhi fotografik ndryshon nga imazhi artistik i pikturës apo
--	--

<p>Konstruksoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Materiale të ndryshme dhe të riciklueshme. 	<p>vizatimit dhe është mënyra kryesore e komunikimit vizual e këtij shekulli;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor një aparat të thjeshtë fotografik për një qëllim të caktuar, duke kompozuar saktë; - kupton mënyrën se si zhvillohet një projekt artistik nëpërmjet shënimeve, skicave dhe kërkimeve vizuale; - përdor stile të thjeshta shkrimi, të shkëputura e të prera nga revista, gazeta, etj, dhe të ngjitura, për një qëllim të caktuar, duke organizuar hapësirën së bashku me një imazh fotografik; - modelon vazo ose një relief të thjeshtë, duke përdorur materiale, si: plastelinë, carta pesta; - gdhend figura të thjeshta, duke përdorur materiale të buta, si: sapun, bukë peshku; - përdor materialet e dhura nëpërmjet proceseve, si: prerja, dhënia formë, ngjitja dhe ndërtimi i një strukture (letra e kartona, tela të përkulshëm, drunj me nyje, unaza perdeshe, material copash të qepura dhe të mbushura, tapa shishesh, shishe plastike etj); - mbështet për punën e tij në imazhet e veprave të artit, artizanatit, trashëgimisë kulturore, dizajnit, nga historia e artit dhe kultura botërore dhe shqiptare, në lidhje me njohuritë dhe tematikat mësimore në program; - analizon dhe vlerëson punën e vet dhe të tjerëve.
<p>KLASA 7</p>	
<p>Vizatimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat grafike: rapitografi, lapsat me ngjyra. <p>Piktura:</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - eksperimenton dhe krijon me mjete dhe teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në natyrë, në mjedis, në eksperiencën personale, të fantazia për të komunikuar ide;

<ul style="list-style-type: none"> - Tempera, kolazhi. <p>Stampimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monotipi, stampa me gdhendje dhe stampime stensil. <p>Fotografia:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Imazhe fotografike, aparati fotografik. <p>Grafk dizajni dhe prezantimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekt artistik. <p>Skulptura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Modelimi me plastelinë, baltë, karta pesta. - Gdhendja mbi materiale të buta. - Derdhja forma pozitive dhe forma negative <p>Konstruksoni:</p> <p>Materiale të ndryshme dhe të riciklueshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - krijojn duke përdorur karakteristikat shprehëse të mjeteve të vizatimit si: gradacionet tonale të rapitografit dhe lapsave me ngjyra; - paraqet formën tre dimensionale mbi sipërfaqen dy dimensionale; - zbulon mundësitë shprehëse që ofron teknika e temperës dhe i përdor në krijim; - zbulon karakteristikat e teknikës së kolazhit dhe mundësitë e shumta të kombinimit të materialeve dhe i përdor në krijim për një qëllim të caktuar; - krijon stampa me gdhëndje, stampa stensil dhe stampon mbi sipërfaqe me teksturë të ndryshme; - përdor rulin si mjet ndihmës për stampim; - kupton se si funksionon dhoma e errët e aparatit fotografik; - përdor aparatin fotografik për një qëllim të caktuar, duke kompozuar saktë dhe duke eksperimentuar burimin e dritës; - analizon mesazhin që do të përcjellë dhe përzgjedh mjetet e duhura artistike për të përcjellë këtë mesazh; - familjarizohet me imazhe që kanë lidhje në vazhdimësi me njëra-tjetrën, duke përfshirë analizën e procesit dhe veprimtarinë, si storibordi i filmave vizatimorë dhe krijon një të tillë; - shton interesin në fushën e komunikimit vizual, duke vlerësuar shembuj të grafik dizajn në përdorim, si p.sh.: reklamat e dyqaneve, reklamat e autobusëve, revistat dhe gazetat, shenjat e rrugëve etj; - dallon karakteristikat e alto relievit, baso relievit dhe skulpturës së rrumbullakët; - modelon me baltë një altoreliev dhe një natyrë të qetë në skulpturë të
--	--

	<p>rrumbullakët;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton dhe përdor formën negative dhe pozitive me baltë ose allçi; - gdhend figura të thjeshta, duke përdorur materiale të buta, si: sapun, bukë peshku; - krijon objekte funksionale dizajni ose arkitekture, kukulla ose maska duke përdorur materiale me cilësi të ndryshme (të buta, të forta, të përthyeshme, etj) dhe materiale të riciklueshme ; - mbështet për punën e tij në imazhet e veprave të artit, artizanatit, trashëgimisë kulturore, dizajnit, nga historia e artit, kultura botërore dhe shqiptare, në lidhje me njohuritë dhe tematikat mësimore në program; - analizon dhe vlerëson punën e vet dhe të tjerëve.
KLASA 8	
<p>Vizatimi - Teknikat grafike: pastelet.</p> <p>Piktura - Teknika piktorike eksperimentale, spruco pikëzime, përzierje materialesh, etj.</p> <p>Stampimi Ndërhyrje mbi imazhet e stampuara dhe fotografike. - Teknika stampimi dekorative.</p> <p>Fotografia - Gjinitë e fotografisë.</p> <p>Grafik dizajni dhe prezantimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> -eksperimenton dhe krijon me mjete dhe teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në natyrë, në mjedis, në eksperiencia personale dhe te fantazia për të komunikuar ide; - krijojn duke përdorur karakteristikat shprehëse të teknikës së pastelit; - eksperimenton me teknika të ndryshme në krijim, si spruco, pikëlime, etj., - përdor teknika stampimi të ndryshme për të ndërhyrë në fotografi për një qëllim të caktuar; - eksperimenton me teknika të ndryshme stampimi duke dekoruar mbi objekte me materiale të ndryshme; - identifikon gjinitë e fotografisë; - përdor aparatën fotografik për të realizuar natyra të qeta, peizazhe, portret, etj. - identifikon simbolet dhe sistemin e simboleve në kultura të ndryshme dhe të

<p>- Imazhi i reklamës.</p> <p>Skulptura</p> <p>- Modelimi me plastelinë, baltë ose karta pesta. (Maska)</p> <p>- Gdhendja mbi materiale të buta. (Portret)</p> <p>Konstruksoni.</p> <p>- Materiale të ndryshme dhe të riciklueshme. (skulpturë me materiale të riciklueshme, mokat ndërtese në arkitekturë).</p>	<p>njëjta dhe i përdor aro në krijim;</p> <p>- analizon idenë dhe informacionin që përcjell një reklamë;</p> <p>- modelon një maskë, duke përdorur materiale, si: plastelinë ose carta pesta;</p> <p>- gdhend portretin e një personazhi, duke përdorur materiale të buta, si: sapun, bukë peshku, parafinë;</p> <p>- krijon skulptura kinetike me materiale të riciklueshme duke iu referuar krijimeve të Calder;</p> <p>- vlerëson shembuj të arkitekturës nga historia e artit, objekte funksionale dizajni dhe artizanati;</p> <p>- krijon mokane të ndërtesave me materiale të ndryshme të riciklueshme dhe karton;</p> <p>- mbështetet për punën e tij/saj në imazhet e veprave të artit, artizanatit, trashëgimisë kulturore, dizajnit, nga historia e artit dhe kultura botërore dhe shqiptare, në lidhje me njohuritë dhe tematikat mësimore në program;</p> <p>- analizon dhe vlerëson punën e vet dhe të tjerëve.</p>
<p>KLASA 9</p>	
<p>Vizatimi</p> <p>- Teknikat grafike: lapustilat dhe përdorime të ndryshme.</p> <p>Piktura</p> <p>- Grafiti urban.</p> <p>Stampimi</p> <p>- Teknika stampimi dekorative.</p> <p>Fotografia</p>	<p>- eksperimenton dhe krijon me mjete dhe teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në natyrë, në mjedis, në eksperiencë personale dhe te fantazia për të komunikuar ide;</p> <p>- krijon duke përdorur karakteristikat shprehëse të teknikës me lapustila;</p> <p>- identifikon karakteristikat e teknikës së grafitit urban;</p> <p>- skicon dhe ideon temën e një grafiti dhe e realizon në tabakë letre;</p> <p>- përdor teknika të ndryshme stampimi për dekorimin e objekteve të ndryshme të dizajnit;</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Fotokolazhi. <p>Dizajni dhe prezantimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstil dizajni; Fashion dizajni. <p>Skulptura</p> <ul style="list-style-type: none"> - Modelimi me materiale të ndryshme. - Gdhendja mbi materiale të buta. - Derdhja forma pozitive dhe forma negative. <p>Konstruksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Maket skene në miniaturë me materiale të ndryshme dhe të riciklueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> - krijon në teknikën e fotokolazhit për të komunikuar ide duke u mbështetur në shembuj të ndryshëm të fotokolazhit artistik; - projektton një model të thjeshtë të endjes ose të dekorimit duke përzgjedhur materialet e përshtatshme; - ideon një veshje duke përdorur teknika grafike të vizatimit ose materiale të riciklueshme; - modelon figurën e njeriut me tel ose materiale të buta (personazh të teatrit të kukullave etj.); - gdhend objekte ose figurën e njeriut, duke përdorur materiale të buta, si: sapun, bukë peshku, parafinë (në raste të mundshme gur shtufi) etj.; - krijon formën negative me baltë (ose përdor forma negative të gatshme të improvizuara) për të derdhur bizhuteri ose objekte të thjeshta me allçi; - zbulon që skenografia është një bashkësi elementesh artistikë (konstruksione tredimensionale, piktura, kostumet dhe elemente të tjera teknikë); - ndërton një maket skene në miniaturë për teatër kukullash ose shfaqje për fëmijë; - mbështetet për punën e tij në imazhet e veprave të artit, artizanatit, trashëgimisë kulturore, dizajnit, nga historia e artit, kultura botërore dhe shqiptare, në lidhje me njohuritë dhe tematikat mësimore në program; - analizon dhe vlerëson punën e vet dhe të tjerëve.
---	--

3.3.Tematika: Historia, arti dhe shoqëria

Përshkrimi i Tematikës

Në këtë tematikë nxënësi/sja:

analizon dhe interpreton vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social kulturor. Ai komunikon emocionet dhe gjykimin e tij mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij dhe të shokut. Duke ju referuar historisë së artit dhe kulturës nxënësi, pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e njohur më mirë atë. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, gjithashtu respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi artistik:** përdor ide personale dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike; Përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike; Analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- **Realizimi i punit:** zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim; merr në konsideratë target grupin të cilit i referohet me idetë e tij/saj; eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; Analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- **Vlerësimi artistik:** identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; identifikon veprat e artit në aspektin e tyre historik; identifikon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj; interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA 6

Histori arti :

- Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore.)

Eksperiencia artistike:

- Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës.
- Takime me artistë, dizajnë, artizanë, arkitektë etj.

Ekspozita dhe evente kulturore:

- Vizita në muzeume, (arkeologji, etnografi) galeri arti, qendra kulturore, site arkeologjike, objekte të trashëgimisë kulturore, etj.
- Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet.

Media:

Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter, etj.

Nxënësi :

- analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe nga kultura të tjera, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor;
- identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti;
- identifikon subjektin dhe simbolikën e veprës dhe shpjegon përjetimin dhe vlerësimin për të;
- argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën;
- përdor fjalorin e duhur si në gjuhën e folur ashtu edhe të shkruar për të komunikuar vlerësimin e tij;
- respekton përjetimin dhe vlerësimin e të tjerëve;
- zbulon eksperiencia të ndryshme artistike dhe profesione që lidhen me artin pamor, nëpërmjet takimeve me artistë të ndryshëm si të ftuar në shkollë, nëpërmjet vizitave në vendin e tyre të punës, nëpërmjet informacionit që marrin gjatë orës së mësimit dhe informacionit të mbledhur nga burime të ndryshme informacioni;
- viziton muze, galeri, qendrën kulturore, site arkeologjike, etj.
- merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet;
- përdor burime të ndryshme informacioni;
- prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe autorëve të tyre;
- prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe

	trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.
KLASA 7	
<p>Histori arti :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore.) <p>Eksperiencia artistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës. - Takime me artistë, dizajnë, artizanë, arkitektë etj. <p>Ekspozita dhe evente kulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në muzeume, (arkeologji, etnografi) galeri arti, qendra kulturore, site arkeologjike, objekte të trashëgimisë kulturore, etj. - Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet. <p>Media:</p> <p>Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter, etj.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe nga kultura të tjera, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor; - identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti; - identifikon subjektin dhe simbolikën e veprës dhe shpjegon përjetimin dhe vlerësimin e për të; - argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën; - përdor fjalorin e duhur si në gjuhën e folur ashtu edhe të shkruar për të komunikuar vlerësimin e tij; - respekton përjetimin dhe vlerësimin e të tjerëve. - zbulon eksperiencë të ndryshme artistike dhe profesione që lidhen me artin pamor, nëpërmjet takimeve me artistë të ndryshëm, si të ftuar në shkollë, nëpërmjet vizitave në vendin e tyre të punës, nëpërmjet informacionit që marrin gjatë orës së mësimit dhe informacionit të mbledhur nga burime të ndryshme informacioni. - viziton muze, galeri, qendrën kulturore, site arkeologjike, etj; - merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet; - përdor burime të ndryshme informacioni; - prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe

	<p>autorëve të tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.
KLASA 8	
<p>Zhvillimi i artit në periudhën:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Baroke, - Klasike, - Romantike, - Realiste, - Impresioniste. <p>Zhvillimi i artit në Shqipëri në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX</p> <p>Trashëgimi kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veshjet popullore (Shqiptare). <p>Ekspozita dhe ngjarje kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet. <p>Media</p> <p>Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter, etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe nga kultura të tjera, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor; - identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, stilin, aspektet historike në një vepër arti; - identifikon subjektin dhe simbolikën e veprës dhe shpjegon përjetimin dhe vlerësimin për të; - argumenton dhe komunikon mendimin e tij/saj mbi veprën duke përdorur një fjalor të pasur artistik; - pasuron perceptimin dhe njohuritë mbi botën që e rrethon; - identifikon artet vizuale në ambientin që e rrethon duke kuptuar rolin dinamik të artit në shoqëri; - respekton mendimin ndryshe të të tjerëve; - zbulon shumëllojshmërinë e veshjeve popullore shqiptare; - identifikon karakteristikat kryesore të veshjeve popullore shqiptare; - merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet; - prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe

	<p>autorëve të tyre;</p> <p>- prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.</p>
KLASA 9	
<p>Vepra arti nga periudha të ndryshme²</p> <p>Zhvillimi i artit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Postimpresionizmi. - Avangardat artistike (fovizmi, ekspresionizmi, kubizmi, abstraksionizmi, dadaizmi, surrealizmi,). - Arti në gjysmën e dytë të shekullit XX (ekspresionizmi abstrakt, pop arti, skulptura, arkitektura). - Arti në Shqipëri në periudhën e ndërtimit të socializmit. <p>Trashëgimi kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qytetet muze dhe arkitektura e tyre tradicionale. <p>Ekspozita dhe ngjarje kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe nga kultura të tjera, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor; - identifikon elementët e gjuhës pamore, teknikën e përdorur, stilin, aspektet historike në një vepër arti; - identifikon subjektin dhe simbolikën e veprës dhe shpjegon përjetimin dhe vlerësimin për të; - argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën duke përdorur një fjalor të pasur artistik; - pasuron perceptimin dhe njohuritë mbi botën që e rrethon; - identifikon artet pamore në ambientin që e rrethon duke kuptuar rolin dinamik të artit në shoqëri; - respekton përjetimin dhe vlerësimin e të tjerëve; - vlerëson qytetet muze apo qendrat historike të qyteteve në Shqipëri (Gjirokastra, Berati, etj.) si pjesë të rëndësishme të trashëgimisë tonë kulturore;

²Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme mund të përdoren për të ilustruar njohuritë në tematikat “Gjuha dhe komunikimi artistik” dhe “Teknika dhe procese artistike”.

<p>Media Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter, etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon karakteristikat e arkitekturës tradicionale të banesave qytetare; - merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet; - prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe autorëve të tyre; - prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.
<p>Qëndrime dhe vlera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh përmes vëzhgimit, karakteristika të veprave të artit dhe dizajnit, objekteve të trashëgimisë kulturore dhe artizanatit; - shpreh ide, ndjenja dhe eksperiencia nëpërmjet artit pamor për një audiencë të caktuar; - përdor një fjalor të përshtatshëm artistik kur përshkruan dhe analizon një vepër arti; - shpreh idetë e veta për vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore; - demonstroi vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike; - shprehet dhe komunikoi në mënyrë të pavarur; - merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike vetëm dhe në grup; - përdor imagjinatën dhe kreativitetin gjatë realizimit të një punimi; - interpretoi objekte nga natyra në mënyrë origjinale; - demonstroi vetëbesim në krijimet e veta vetëm ose në grup; - bashkëpunoi me të tjerë në një veprimtari artistike; - respektoi diversitetin ndaj kulturave të ndryshme; - respektoi krijimet e veta dhe të tjerëve; - mban qëndrim ndaj veprave të artit, dizajnit, artizanatit dhe objekteve të trashëgimisë kulturore; - njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe atë të kulturave të tjera; 	

- zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë krijimit ose zhvillimit të aktiviteteve artistike;
- demonstroi përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese;

IV. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënësve dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, ç'ka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamor, synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar.***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete, etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënësve në artin pamor;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë të artit pamor;

- rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e veprimtarive në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat e artit pamor, që janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura, dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktiv kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “..pse më pëlqen?”, “...a duket bukur?”, “..çfarë ndodh nëse e vendos objektin më afër?” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja.

Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e fëmijëve në mësimin e artit. Mësuesit duhet të inkurajojnë çdo nxënës të besojë se do të jetë i suksesshëm në mësimin e artit, të kuptojnë interesat e nxënësve, nevojat që ata kanë, të ndihmojnë nxënësit të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të rendisin udhëzimet që do të përdorin, duke diferencuar udhëzimet për nxënës me nevoja të veçanta; po kështu mësuesit duhet të stimulojnë dhe inkurajojnë të gjithë nxënësit, duke krijuar mjedise ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar mbi artin pamor në mënyra që janë të rëndësishme për ta.

Mësuesit mund ta realizojnë këtë nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, duke nxitur pjesëmarrjen me eksperiencën krijuese dhe me materiale konkrete. Planifikimi i kohës, hapësira e përshtatshme dhe një shumëllojshmëri materialesh janë të rëndësishme për të mbështetur një mësimdhënie efektive. Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitete të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve, në nevojat e grupit dhe në praktikat më të mira mësimore. Gjithashtu, mësuesit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të “Artit pamor” që nxit idetë e reja tek nxënësit.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integrale me lëndët tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së mësimin bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqëndrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive pamore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (psh. vetvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofol me punë artistike, prezantim me gojë, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.)

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në artin pamor, vlerësimi mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale dhe në bashkëpunimin e realizimit të temave mësimore në grup. *Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi*

artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave të artit pamor të nxënësve, përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në lëndën e artit pamor janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th. përmes *krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit* etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstronë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në artin pamor. Ai mund të përmbajë krijime, organizime dhe projekte kurrikulare, në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj.

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

VI. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë zhvillimit të mësimin në lëndën e artit pamor, për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin pamor duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj, duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde. Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës artistike pamore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/Ajo u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtjet e caktuara ose shkathtësitë që ata duhet të performojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësuesi duhet të demonstrojnë drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e “Artit pamor”. Është shumë e rëndësishme për nxënësit e kësaj moshe lidhja midis demonstrimit të mësuesit dhe dhënia mundësi e përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Në këtë mënyrë ata do të krijojnë pavarësi në përdorimin e mjeteve nga një nivel në tjetrin. Kur mësuesit i duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë të gjitha format e artit nga e gjithë bota dhe nga kultura të ndryshme.

Programi i “Artit pamor” u jep të gjithë nxënësve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sërë mjeteve dhe teknikave artistike dhe të vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit në orën e artit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues.
- Fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore, etj.
- Riprodhime të veprave të artit dhe postera.
- *Mjetet audiovizive si:* Tv, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin pamor. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese.
- *Mjedisi mësimori:* (klasa, kabinetet e artit pamor, etj.).